

INTELIJENCA ARTIFICIALE NË GAZETARI

UDHËZUES PRAKTIK PËR MEDIAN
DHE GAZETARËT NË SHQIPËRI



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË GAZETARI

UDHËZUES PRAKTIK PËR MEDIAN DHE GAZETARËT NË SHQIPËRI



Tiranë, 2026

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Titulli: INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË GAZETARI

Udhëzues praktik për median dhe gazetarët

në Shqipëri

Autorë: Erlis Çela, Emirjon Senja

Bashkëpunëtorë: Kristina Lani, Agim Doksani, Kejsi Bozo

Kopertina dhe layout: Bujar Karoshi

Ky manual është realizuar në kuadrin e projektit “Inteligjenca Artificiale në funksion të konsolidimit demokratik”, i zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, në kuadër të programit MATRA. Pikëpamjet e shprehura në këtë manual nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja

HYRJE	4
Përse na duhet ky manual?	4
Çfarë është Inteligjenca Artificiale në kontekstin e gazetarisë?	7
Integrimi i Inteligjencës Artificiale në redaksi	12
PËRDORIMI I IA NË PROCESIN GAZETARESK	16
Përdorimi i IA në mbledhjen, menaxhimin dhe prodhimin e përmbajtjes	16
Si të përdorim Inteligjencën Artificiale në gazetarinë vizuale dhe multimediale	21
Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetarinë investigative	24
Si të përdorim IA për verifikimin e fakteve?	29
Inteligjenca Artificiale në analizën e trendeve dhe menaxhimin e audiencës	33
Menaxhimi i Rreziqeve	37
NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE NË MEDIA	41
Si të zhvillojmë aftësitë e gazetarëve në përdorimin e IA	41
Si të përcaktojmë përgjegjësinë editoriale për përdorimin e IA?..	42

HYRJE

Përse na duhet ky manual?

Transformimi i gazetarisë nga Inteligjenca Artificiale

Inteligjenca Artificiale po ndryshon me shpejtësi mënyrën se si prodhohet, analizohet dhe shpërndahet informacioni. Në redaksitë e lajmeve, mjetet e Inteligjencës Artificiale po përdoren gjithnjë e më shpesh për të kryer detyra të ndryshme. Këtu përfshihen transkriptimi i intervistave, përkthimi i përmbajtjes, analiza e të dhënave, identifikimi i trendeve, automatizimi i prodhimit të lajmeve dhe procese të tjera. Këto zhvillime po transformojnë rutinat gazetareske në të gjitha fazat; nga mbledhja e informacionit, te përpunimi dhe publikimi i përmbajtjes.

Në shumë redaksi, në mbarë botën, mjetet e Inteligjencës Artificiale janë bërë pjesë e përditshme e punës. Këto mjete mund të ndihmojnë gazetarët të analizojnë sasi të mëdha dokumentesh në kohë të shkurtër, të identifikojnë modele në të dhëna komplekse dhe të automatizojnë detyra rutinë që, më parë, kërkonin shumë kohë dhe burime njerëzore. Nga ana tjetër falë IA, përgatitja dhe rekomandimi i lajmeve për audiencën po automatizohet gjithnjë e më shumë. Njëkohësisht Inteligjenca Artificiale ndihmon në segmentimin dhe profilizimin e audiencave, duke i dhënë mundësi medias të përcaktojë preferencat e përdoruesve dhe konsumatorëve të lajmit¹. Kjo i lejon gazetarët të përqendrohen më shumë në aspektet analitike, hulumtuese dhe interpretuese të profesionit.

Megjithatë, ky transformim nuk është vetëm teknologjik. Inteligjenca Artificiale ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si zhvillohet gazetaria, në rolin e gazetarëve dhe në marrëdhënien midis medias dhe audiencave. Transformimi që ka nxitur IA nuk po prek vetëm mënyrën se si prodhohet përmbajtja, por edhe mënyrën se si ajo arrin te publiku.

Për një kohë të gjatë, media ka funksionuar sipas një modeli të drejtpërdrejtë komunikimi, të njohur si *Business-to-Consumer (B2C)*, ku lajmi kalonte nga redaksia/gazetari te publiku, pa ndërmjetës. Sot, kjo marrëdhënie po bëhet më komplekse dhe kërkon vëmendje dhe diskutim

¹ Jones, B., Jones, R., & Luger, E. (2022). AI 'Everywhere and Nowhere': Addressing the AI Intelligibility Problem in Public Service Journalism. *Digital Journalism*, 10(10), 1731-1755. <https://doi.org/10.1080/21670811.2022.2145328>

më të kujdesshëm. Në epokën që po jetojmë përmbajtja nuk krijohet vetëm për t'u konsumuar nga njerëzit, por edhe për t'u përpunuar nga sistemet e Inteligjencës Artificiale, duke kaluar drejt modelit Business-to-Agent (B2A). Kjo do të thotë se “audiencia” e medias nuk është më vetëm publiku, por edhe teknologjitë që lexojnë, analizojnë dhe organizojnë informacionin në mënyrë të automatizuar.

Në këtë realitet të ri, po konsolidohet një model i ndërmjetëm, *Business-to-Agent-to-Consumer (B2A2C)*, ku Inteligjenca Artificiale shërben si ura lidhëse midis medias dhe publikut. Shpesh, audiencia nuk përballet më drejtpërdrejt me përmbajtjen origjinale, por me versione të përpunuara dhe të personalizuara nga IA. Kjo rrit ndjeshëm rolin e teknologjisë në formësimin e mënyrës se si kuptohet dhe interpretohet realiteti².

Mundësitë dhe rreziqet

Si çdo valë e re teknologjike që ka prekur zhvillimin e medias dhe gazetarisë, edhe Inteligjenca Artificiale vjen me mundësitë e dhe rreziqet e saj. IA krijon padyshim mundësi të reja për gazetarinë dhe zhvillimin e medias. Ajo mund të rrisë efikasitetin e redaksive, të ndihmojë në analizën e të dhënave komplekse dhe të mbështesë prodhimin e përmbajtjes në mënyrë më të shpejtë dhe më të strukturuar. Për shembull, mjetet e Inteligjencës Artificiale mund të ndihmojnë në verifikimin e informacionit, në monitorimin e rrjeteve sociale, ose në analizën e dokumenteve voluminoze gjatë një investigimi.

Megjithatë, përdorimi i Inteligjencës Artificiale shoqërohet edhe me rreziqe serioze. Një pjesë e këtyre rreziqeve trajtohen gjerësisht në diskursin publik, veçanërisht në lidhje me ndikimin e IA në media dhe në shoqëri. Studiues të ndryshëm i kanë përmbledhur këto rreziqe në gazetari në tre dimensione kryesore: së pari, mundësia që IA të shndërrohet në një mjet për përhapjen e dezinformimit në shkallë të gjerë; së dyti, rreziku për të komprometuar norma thelbësore profesionale, si objektiviteti dhe verifikimi i informacionit; dhe së treti, kërcënimi potencial ndaj praktikave ekzistuese dhe vetë punës së gazetarisë³.

² Fang, S. (2025, July 2). AI is your newest audience: The B2A(2C) design challenge. London. <https://splicemedia.com/stories/ai-is-your-newest-audience-the-b2a2c-design-challenge>

³ Matich, P., Thomson, T. J., & Thomas, R. J. (2025). Old Threats, New Name? Generative AI and Visual Journalism. *Journalism Practice*, 19(10), 2402-2421. <https://doi.org/10.1080/17512786.2025.2451677>

Sistemet e IA mund të prodhojnë informacion të pasaktë, të përforcojnë paragjykimet ekzistuese në të dhëna ose të krijojnë përmbajtje që duket bindëse, por nuk është e verifikuar. Në disa raste, përdorimi i pakontrolluar i këtyre teknologjive mund të dëmtojë besimin e publikut ndaj medias.

Nga ana tjetër teknologjitë e reja krijojnë sfida të rëndësishme etike dhe profesionale. Ruajtja e përgjegjësisë editoriale në kushtet e përdorimit të mjeteve automatike, sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut, si dhe mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialitetit të burimeve gazetareske, përbëjnë çështje thelbësore që kërkojnë vëmendje të shtuar.

Udhëzimet e publikuara nga Instituti Shqiptar i Medias e bazojnë përdorimin etik të Inteligjencës Artificiale në mediat shqiptare në tre parime bazë, të cilat përfshijnë ruajtjen e besimit të audiencave të media; përdorimin e teknologjisë nën mbikëqyrjen njerëzore dhe sigurimin e transparencës⁴.

Përse nevojitet një qasje e strukturuar për median në Shqipëri?

Në Shqipëri, përdorimi i Inteligjencës Artificiale në media është ende në fazat e para, me një prirje të dukshme për t'u rritur ndjeshëm në të ardhmen. Shumë redaksi tashmë përdorin mjete të ndryshme digjitale që përfshijnë elemente të IA. Studimet tregojnë se gazetarët në Shqipëri e përdorin Inteligjencën Artificiale për të shkruar automatikisht lajme të thjeshta, për të përkthyer materiale dhe për të transkriptuar intervista, duke u dhënë atyre më shumë kohë për analiza të thelluara⁵. Megjithatë duhet pranuar se shpesh përdorimi i IA bëhet pa qenë plotësisht të vetëdijshëm për mënyrën se si funksionon apo për rreziqet që këto mjete mund të paraqesin. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që mediat shqiptare të zhvillojnë një qasje të qartë dhe të strukturuar ndaj përdorimit të Inteligjencës Artificiale. Një qasje e tillë duhet të sigurojë që teknologjia të përdoret për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë dhe jo për ta zëvendësuar atë.

Ky manual synon të ndihmojë redaksitë, gazetarët dhe drejtuesit e mediave në Shqipëri të kuptojnë më mirë mundësitë, kufizimet dhe rreziqet e Inteligjencës Artificiale dhe të vendosin rregulla të qarta për përdorimin e saj në praktikën gazetareske.

⁴ <https://institutemedia.org/udhezimet-per-perdorimin-etik-te-inteligjences-artificiale-ne-median-shqiptare/>

⁵ Çipuri, R., Çela, E., & Saliu, H. (2025). AI in the Newsroom: Changes and Challenges in Albania. *Družboslovna revija Interdisciplinary Journal of Social Science*, 621.

Çfarë është Inteligjenca Artificiale në kontekstin e gazetarisë?

Përkufizimi i teknologjive të reja mbetet gjithnjë një sfidë, veçanërisht kur ato gjejnë zbatim në fusha të ndryshme të shoqërisë. Nisur nga ky fakt është sfiduese të gesh një përkufizim shterues të Inteligjencës Artificiale, që do të përfshinte të gjitha format dhe mënyrat e aplikimit. Megjithatë një përkufizim i përgjithshëm i Inteligjencës Artificiale (IA) mund të jetë ai që tregon natyrën teknologjike të saj.

Në këtë kontekst IA konsiderohet si një koleksion idesh, teknologjish dhe teknikash që lidhen me aftësinë e një sistemi kompjuterik për të kryer detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore⁶. Me pak fjalë këto janë algoritme dhe modele të sofistikuar, të cilat mund të analizojnë të dhëna në sasi të mëdha, të gjenerojnë përmbajtje, të nxjerrin përfundime nga analizimi i teksteve, dhe të ofrojnë rekomandime në kohë reale.

Nga ana tjetër, ajo që njihet si IA gjenerative/gjeneruese mund të përkufizohet si një teknologji e aftë për të krijuar përmbajtje të re, duke përfshirë tekst, imazhe, audio, video apo forma të tjera mediatike, bazuar në të dhënat mbi të cilat është trajnuar dhe në përgjigje të kërkesave të formuluar me shkrim.⁷

Në kontekstin e gazetarisë, IA gjeneruese mund të përdoret për të kryer një gamë të gjerë detyrash përgjatë gjithë procesit të raportimit, që nga mbledhja e informacionit, deri te prodhimi, verifikimi dhe shpërndarja e lajmeve. Këto detyra përfshijnë, ndër të tjera, shkrimin e teksteve, përmbledhjen dhe përkthimin e raporteve të gjata.

Inteligjenca Artificiale mund të përmirësojë efikasitetin dhe saktësinë e raportimit të lajmeve, të personalizojë përmbajtjen për audiencat dhe të ndihmojë në luftën kundër dezinformimit. Gazetarët dhe redaktorët mund ta përdorin Inteligjencën Artificiale për përpunuar, analizuar informacionin në mënyrë të automatizuar dhe për të parashikuar prirjet e lexuesve në kohë reale. Kjo do t'i ndihmojë ata të reduktojnë ngarkesën e punës, por edhe të përdorin sistemet e automatizuara në formën e një asistenti personal që i bën të kuptojnë më mirë preferencat e audiencës.

⁶ <https://www.lse.ac.uk/media-and-communications/polis/JournalismAI/Starter-Pack>

⁷ Cools, H., & Diakopoulos, N. (2026). Uses of Generative AI in the Newsroom: Mapping Journalists' Perceptions of Perils and Possibilities. *Journalism Practice*, 20(3), 878-896. <https://doi.org/10.1080/17512786.2024.2394558>

Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në identifikimin e lajmeve të rreme ose të manipuluar duke kryqëzuar në kohë rekord burime të shumta dhe duke analizuar autenticitetin e përmbajtjes. Përdorimi i një kapaciteti të tillë të Inteligjencës Artificiale bëhet veçanërisht i rëndësishëm në një epokë si kjo e tanishmja ku lajmi i rremë mund të përhapet shumë shpejt.

Përkufizime të nevojshme

Në kuadër të këtij manuali, është nevojshme që të qartësohen disa përkufizime të termave dhe koncepteve që lidhen me Inteligjencën Artificiale dhe që përdoren shpesh në mjedisin gazetaresk dhe diskursin rreth përdorimit të IA në media.

IA gjenerative: Një lloj i Inteligjencës Artificiale që krijon përmbajtje të re, si tekst, imazhe ose përmbajtje multimediale, duke interpretuar dhe prodhuar, bazuar në të dhënat hyrëse.

Modele gjuhësore në shkallë të gjerë (LLM): Sisteme të Inteligjencës Artificiale të trajnuara mbi sasi shumë të mëdha të dhënash, të afta për të kuptuar dhe prodhuar gjuhë të ngjashme me atë njerëzore. LLM përbën bazën kryesore që fuqizon Inteligjencën Artificiale gjeneruese.

Prompt-Komandë/kërkesë: Udhëzim specifik që i jepet një mjeti të IA për të prodhuar një rezultat të dëshiruar.

Halucinacion: Fenomeni ku IA gjeneron informacion ose përgjigje që janë të sajura, të pasakta ose të pabazuara në fakte.

Të dhëna trajnimi: Seti i të dhënave, artikuj, punime kërkimore ose postime në mediat sociale, të përdorura për të mësuar një mjet IA, modele, marrëdhënie dhe njohuri për të bërë parashikime ose për të prodhuar përmbajtje.

Dallimi mes Inteligjencës Artificiale dhe “Machine Learning”

Termet “inteligjencë artificiale” dhe “machine learning” përdoren shpesh si sinonime, por në fakt nuk janë e njëjta gjë.

Inteligjenca Artificiale është një term i gjerë që përfshin një sërë teknologjish dhe metodash që lejojnë kompjuterët të kryejnë detyra inteligjente. Brenda këtij kuadri, “machine learning” është një nga teknikat më të rëndësishme.

Machine learning është një metodë që lejon sistemet kompjuterike të mësojnë nga të dhënat dhe të përmirësojnë performancën e tyre me

kalimin e kohës pa qenë të programuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për çdo detyrë. Për shembull, një sistem i machine learning mund të analizojë mijëra artikuj për të mësuar se si të identifikojë temat kryesore në lajme ose të njohë modele të caktuara në të dhëna.

Në praktikë, shumë nga mjetet moderne të Inteligjencës Artificiale që përdoren në gazetari bazohen pikërisht në teknika të **machine learning**.

Çfarë konsiderohet përdorim editorial i IA?

Përdorimi editorial i Inteligjencës Artificiale i referohet çdo përdorimi të këtyre teknologjive që ndikon drejtpërdrejt në prodhimin, përpunimin ose shpërndarjen e përmbajtjes gazetareske.

Kjo mund të përfshijë, ndër të tjera përdorimin e IA:

- për të analizuar të dhëna gjatë një investigimi
- për transkriptimin automatik të intervistave
- për të prodhuar tituj dhe përmbledhje
- për të shpërndarë ose kuruar përmbajtje
- për të mbështetur prodhimin editorial ose kërkimin
- për të automatizuar prodhimin e lajmeve
- për hulumtime gazetareske
- për të shfrytëzuar përmbajtjen në arkivat
- për të kuptuar prirjet dhe preferencat e audiencave
- për të optimizuar angazhimin dhe abonimet
- për kontrollin dhe verifikimin e fakteve
- për moderimin e komenteve
- për të optimizuar përdorimin e imazheve
- për të identifikuar dhe zbutur rreziqet e paragjyqimeve

Në të gjitha këto raste, edhe pse teknologjia mund të asistojë në proces, vendimet editoriale përfundimtare duhet të merren nga gazetarët dhe redaktorët.

Parimet themelore

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetari duhet të udhëhiqet nga parime të qarta etike dhe profesionale. Këto parime synojnë të sigurojnë që teknologjia të përdoret në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me standardet e gazetarisë.

Transparenca dhe ndjeshmëria ndaj publikut

Është thelbësore që mediat të jenë transparente në lidhje me përdorimin e Inteligjencës Artificiale në proceset e tyre editoriale. Kjo përfshin informimin e audiencës kur përmbajtja është prodhuar ose modifikuar nga sistemet e Inteligjencës Artificiale. Media dhe gazetarët duhet të angazhohen për të dokumentuar dhe shpjeguar për audiencat mjetet e përdorura, në një mënyrë që siguron transparencë dhe nxit mirëkuptimin. Kjo mund të realizohet përmes një shënimi të shkurtër, një mbishkrimi, ose, në raste të caktuara, përmes një shënimi editorial. Kur është e përshtatshme, mund të përfshihet edhe formulimet kërkesave/komandave (prompts) të përdorura për të udhëzuar modelin në gjenerimin e materialit.

Saktësia dhe verifikimi i informacionit

Pavarësisht përdorimit të teknologjisë së avancuar, përgjegjësia për saktësinë apo vërtetësinë e informacionit mbetet mbi gazetarët dhe redaktorët e lajmeve. Për këtë arsye është e domosdoshme që të gjitha të dhënat e përpunuara nga Inteligjenca Artificiale të verifikohen me qëllim shmangien e informacionit të paverifikuar. Kjo përputhet me parimet e Kodit të Etikës, i cili thekson rëndësinë dhe saktësisë në raportim. Gazetarët dhe redaktorët duhet të angazhohen për të monitoruar dhe të adresuar në mënyrë aktive paragjykimet e mundshme në përmbajtjen e prodhuar nga IA, duke garantuar drejtësi dhe barazi në praktikën gazetareske⁸.

Ruajtja e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave

Mediat duhet të respektojnë privatësinë e individëve dhe të sigurojnë që përdorimi i Inteligjencës Artificiale të mos cenonjë të dhënat personale. Përpunimi i të dhënave duhet të bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe me standardet etike, duke shmangur mbledhjen ose shpërndarjen e paautorizuar të informacionit personal. Media duhet të garantojë mospërfshirjen e informacioneve të ndjeshme apo identifikuese që lidhen me audiencën, burimet apo stafin në mjetet gjeneruese të Inteligjencës Artificiale.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Media dhe gazetarët duhet të mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale. Në rast të gabimeve ose

⁸ <https://www.poynter.org/ai-ethics-journalism/ai-ethics-guidelines/>

keqinformimit, është detyrë e medias të korrigjojë informacionin dhe të informojë audiencën për ndryshimet e bëra, duke ruajtur transparencën dhe besueshmërinë. Media duhet të monitorojmë rregullisht mekanizmat e reagimit të audiencës dhe do të integrojë këto reagime në përditësimin e politikave të brendshme.

Parandalimi i njëanshmërisë dhe diskriminimit

Sistemet dhe aplikacionet e Inteligjencës Artificiale mund të reflektojnë paragjyime të pranishme në të dhënat, të cilat përbëjnë bazën e trajnimit të tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që media të monitorojnë dhe të korrigjojnë çdo paragjykim të mundshëm në informacionin e prodhuar nga Inteligjenca Artificiale, duke promovuar një raportim të drejtë dhe të paanshëm.

Edukimi dhe trajnimi i stafit

Për të siguruar përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale është e domosdoshme që gazetarët dhe stafi editorial të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme. Programet e trajnimit duhet të kenë si synim njohjen me kapacitetet dhe kufizimet e teknologjisë, si dhe me çështjet etike që lidhen me përdorimin e saj. Trajnimi i vazhdueshëm ndihmon në integrimin e suksesshëm të Inteligjencës Artificiale në proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit.⁹

Si duhet lexuar dhe përdorur ky manual?

Ky manual është hartuar si një udhëzues praktik për redaksitë dhe gazetarët që duan të kuptojnë dhe të përdorin Inteligjencën Artificiale në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale. Manuali nuk synon të zëvendësojë kodet ekzistuese të etikës së medias, rregullat editoriale të çdo organizate mediatike apo udhëzimet e hartuara për përdorimin etik të IA në media. Dokumenti synon t'i plotësojë kodet dhe udhëzimet e mëparshme, duke ofruar orientime konkrete për përdorimin e teknologjive të reja në praktikën gazetareske.

Manuali mund të lexohet në dy mënyra.

Së pari, ai mund të lexohet si një dokument i plotë, për të krijuar një kuptim të përgjithshëm mbi rolin e Inteligjencës Artificiale në gazetari,

⁹ <https://institutemedia.org/udhezimet-per-perdorimin-etik-te-inteligjences-artificiale-ne-median-shqiptare/>

mundësitë që ajo ofron dhe rreziqet që duhet të menaxhohen.

Së dyti, ai mund të përdoret si një udhëzues praktik për situata konkrete në redaksi. Çdo kapitull trajton një aspekt të veçantë të përdorimit të IA në procesin gazetaresk dhe mund të konsultohet në mënyrë të pavarur, sipas nevojës së redaksisë ose gazetarit.

Manuali është strukturuar në disa pjesë kryesore. Pjesa e parë trajton mënyrën se si redaksitë mund të integrojnë Inteligjencën Artificiale në mënyrë të organizuar dhe të sigurt në proceset e tyre të punës. Pjesa e dytë fokusohet në përdorimin praktik të Inteligjencës Artificiale në procesin gazetaresk. Këtu trajtohen mënyrat se si IA mund të përdoret për prodhimin e përmbajtjes, për analizën e të dhënave, për verifikimin e informacionit dhe për kuptimin e audiencës.

Pjesa e tretë trajton rreziqet që lidhen me përdorimin e këtyre teknologjive dhe mënyrat për t'i menaxhuar ato. Kjo përfshin çështje si paragjykimi algoritmik, përmbajtja e pasaktë e prodhuar nga IA, mbrojtja e të dhënave personale dhe transparenca ndaj publikut.

Ky manual nuk është një dokument statik. Teknologjitë e Inteligjencës Artificiale zhvillohen me shpejtësi dhe mënyrat e përdorimit të tyre në gazetari do të vazhdojnë të evoluojnë me kalimin e kohës. Për këtë arsye, rekomandohet që redaksitë ta shohin këtë manual si një bazë për diskutim dhe zhvillim të politikave të tyre të brendshme, duke e përditësuar dhe përshtatur atë sipas nevojave dhe zhvillimeve të reja teknologjike.

Është e rëndësishme të theksohet se Inteligjenca Artificiale është një mjet në shërbim të gazetarisë, jo një zëvendësim i saj. Roli i gazetarëve në verifikimin e informacionit, në interpretimin e fakteve dhe në mbrojtjen e interesit publik mbetet thelbësor. Teknologjia mund të ndihmojë në këtë proces, por integriteti dhe përgjegjësia editoriale mbeten gjithmonë përgjegjësi njerëzore, e profesionistëve.

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në redaksi

Përpara se Inteligjenca Artificiale të përdoret në mënyrë të gjerë në procesin gazetaresk, është e rëndësishme që redaksitë të vendosin një kuadër të qartë për përdorimin e saj. Integrimi i IA nuk është vetëm një çështje teknologjike, por edhe një çështje organizative dhe editoriale. Redaksitë duhet të dinë se cilat mjete përdoren, për çfarë qëllimesh përdoren dhe kush mban përgjegjësi për përdorimin e tyre.

Kjo pjesë e manualit trajton tre hapa themelorë për integrimin e Inteligjencës Artificiale në redaksi: monitorimin e përdorimit të saj, hartimin e një politike redaksionale dhe integrimin gradual të teknologjive të IA në proceset e punës.

Si të monitorojmë përdorimin e Inteligjencës Artificiale në redaksi?

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në redaksi shpesh fillon në mënyrë spontane. Gazetarët mund të përdorin mjete të ndryshme për transkriptim, përkthim, përmbledhje ose analizë të dhënave, pa pasur gjithmonë një politikë të qartë institucionale për përdorimin e tyre. Për këtë arsye, hapi i parë për një përdorim të përgjegjshëm të IA është monitorimi dhe dokumentimi i përdorimit të saj brenda redaksisë. Në këtë pikë është i nevojshëm identifikimi dhe shpërndarja e studimeve, raporteve, kodeve dhe praktikave të përdorimit në vende të ndryshme të botës. Kjo do të ndihmojë në përditësimin e njohurive të stafëve në lidhje me integrimin e IA në media. Monitorimi nuk ka si qëllim kufizimin e inovacionit, por krijimin e një kuadri të qartë që siguron transparencë dhe përgjegjësi.

Identifikimi i mjeteve të IA që përdoren aktualisht

Hapi i parë është identifikimi i mjeteve të Inteligjencës Artificiale që përdoren nga gazetarët dhe stafi i redaksisë. Kjo përfshin jo vetëm mjetet që janë miratuar zyrtarisht nga redaksia (nëse ekziston një listë e tillë), por edhe ato që përdoren individualisht nga gazetarët. Është e rëndësishme që redaksia të ketë një panoramë të plotë të këtyre mjeteve dhe të kuptojë se në cilat faza të procesit gazetaresk ato përdoren. Në këtë pikë duhet të mbahet parasysh fakti se shpesh përdorimi i Inteligjencës Artificiale shoqërohet me një lloj paragjykimi. Një pjesë e punonjësve të medias që i përdorin këto mjete, ngurrojnë të pranojnë hapur përdorimin e tyre. Për këtë arsye monitorimi mund të kryhet duke përdorur jo vetëm kontrollin dhe vazhdimin e praktikave të përditshme, por edhe përmes mekanizmave të anketimit dhe mekanizmave të tjerë që garantojnë anonimitetin e të intervistuarve.

Përcaktimi i përgjegjësive institucionale

Pas identifikimit të mjeteve, redaksia duhet të përcaktojë se kush mban përgjegjësi për përdorimin e tyre. Në shumicën e rasteve, përgjegjësia editoriale për përdorimin e IA duhet të jetë e ndarë midis:

- redaktorëve, të cilët mbikëqyrin përdorimin editorial të teknologjive
- drejtuesve të redaksisë, që vendosin politikën dhe rregullat e përdorimit
- stafit teknik ose digjital, që mund të mbështesë integrimin e mjeteve të reja

Edhe kur përdoren mjete automatike, përgjegjësia për përmbajtjen e publikuar i mbetet gjithmonë redaksisë.

Krijimi i një regjistri të brendshëm për përdorimin e IA

Një praktikë e rekomanduar është krijimi i një regjistri të brendshëm për përdorimin e IA në redaksi. Ky regjistër mund të përmbajë informacion të tillë si:

- emri i mjetit/aplikacionit të IA
- qëllimi i përdorimit
- departamenti ose gazetari që e përdor
- niveli i mbikëqyrjes editoriale
- rreziqet e mundshme që lidhen me përdorimin e tij

Një regjistër i tillë ndihmon redaksinë të kuptojë më mirë mënyrën se si përdoren këto teknologji dhe të marrë masa nëse është e nevojshme.

Si të hartojmë një politikë redaksionale për përdorimin e IA

Pasi redaksia krijon një pasqyrë të qartë mbi mjetet e Inteligjencës Artificiale që përdor, hapi i radhës është hartimi i një politike të brendshme që përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në përputhje me standardet profesionale të gazetarisë. Kjo politikë duhet të sqarojë qëllimet dhe kufijtë e përdorimit të IA, përgjegjësitë për mbikëqyrje, si dhe procedurat e verifikimit të përmbajtjes së prodhuar. Ky dokument duhet jetë i qartë dhe i aksesueshëm nga i gjithë stafi.

Një parim thelbësor mbetet ruajtja e kontrollit editorial nga gazetarët dhe redaktorët, duke siguruar që çdo përmbajtje e prodhuar me ndihmën e IA të kalojë përmes verifikimit njerëzor përpara publikimit. Njëherësh, transparenca ndaj publikut është thelbësore për ruajtjen e besimit, duke kërkuar informimin e audiencës mbi përdorimin e këtyre teknologjive dhe rolin e tyre në procesin gazetaresk.

Mediat duhet, gjithashtu, të jenë të vetëdijshme për rrezikun e paragjytimeve algoritmike dhe të ndërmarrin masa për minimizimin e tyre përmes verifikimit kritik dhe përdorimit të burimeve të ndryshme.

Po aq e rëndësishme është mbrojtja e të dhënave dhe privatësisë, duke shmangur përdorimin e informacionit të ndjeshëm në mjetet e jashtme të IA. Një proces i qartë vendimmarrjeje brenda redaksisë, që përfshin aktorët kryesorë, ndihmon në përdorimin e kontrolluar dhe të përgjegjshëm të teknologjisë.

Në fund, çdo media duhet të përcaktojë qasjen e saj editoriale ndaj Inteligjencës Artificiale, duke e integruar atë në mënyrë të balancuar dhe në përputhje me misionin dhe vlerat themelore të gazetarisë.

Si të integrojmë IA në mënyrë të sigurt në proceset redaksionale?

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në redaksi duhet të bëhet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar. Qëllimi nuk është të zëvendësohet puna e gazetarëve, por të përdoren teknologjitë për të përmirësuar proceset ekzistuese. Para se një mjet i ri i IA të përdoret gjerësisht në redaksi, është e këshillueshme që ai të testohet në një fazë pilot. Kjo fazë i lejon redaksisë të kuptojë më mirë mënyrën se si funksionon teknologjia dhe çfarë ndikimi ka në procesin e punës. Gjatë fazës pilot, është e rëndësishme të vlerësohen rezultatet që prodhon teknologjia. Kjo përfshin analizimin e saktësisë së rezultateve, identifikimin e gabimeve dhe vlerësimin e ndikimit që teknologjia ka në cilësinë e përmbajtjes.

Trajnimi i stafit dhe monitorimi periodik

Përdorimi i suksesshëm i Inteligjencës Artificiale kërkon që gazetarët dhe redaktorët të kenë një kuptim bazë të mënyrës se si funksionojnë këto teknologji. Pasi një mjet i IA është integruar në redaksi, përdorimi i tij duhet të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Redaksitë duhet të rishikojnë periodikisht mënyrën se si përdoren këto teknologji dhe të përditësojnë politikatat e tyre sipas zhvillimeve të reja teknologjike. Në këtë mënyrë, Inteligjenca Artificiale mund të bëhet një mjet i dobishëm për gazetarinë, duke ruajtur njëkohësisht standardet profesionale dhe besimin e publikut.

PËRDORIMI I IA NË PROCESIN GAZETARESK

Përdorimi i IA në mbledhjen, menaxhimin dhe prodhimin e përmbajtjes

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në procesin gazetaresk nuk kufizohet vetëm te shkrimi i lajmeve për tematika të miratuara paraprakisht nga Bordi Editorial. Në fakt, Inteligjenca Artificiale mund të jetë e pranishme në të gjitha fazat e ciklit të prodhimit të informacionit: nga mbledhja e të dhënave dhe organizimi i tyre, deri te prodhimi dhe shpërndarja automatike e përmbajtjes¹⁰. Kjo e bën atë një mjet të fuqishëm për rritjen e efikasitetit në redaksi, por gjithnjë duke treguar një qasje të kujdesshme për të ruajtur standardet editoriale gjatë të gjitha proceseve.

Në fazën e mbledhjes së informacionit, mjetet e Inteligjencës Artificiale mund të përdoren për të analizuar në kohë të shkurtër sasi të mëdha të dhënash të shpërndara në një numër të madh dokumentesh¹¹, për të identifikuar trende të caktuara në rrjetet sociale apo për të monitoruar burime të ndryshme informacioni.

Gjatë shkrimit të lajmeve investigative, IA mund të ndihmojë në zbulimin dhe filtrimin e databazave voluminoze, duke identifikuar lidhje që do të kërkonin shumë kohë për t'u zbuluar në mënyrë manuale nga një gazetar.

Në fazën e menaxhimit të përmbajtjes, IA mund të përdoret për organizimin e materialeve, përmbledhjen e dokumenteve të gjata dhe klasifikimin e informacionit sipas temave apo prioriteteve editoriale. Kjo është veçanërisht e dobishme për redaksitë që përballen me një fluks të lartë informacioni dhe që duhet të marrin vendime të shpejta mbi publikimin e përmbajtjeve të caktuara.

Ndërsa në fazën e prodhimit të përmbajtjes, Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në hartimin e teksteve në formë drafti, sugjerimin e titujve dhe përshtatjen e përmbajtjes për platforma të ndryshme publikimi.

Në përdorimin e përditshëm në redaksi, Inteligjenca Artificiale mund

¹⁰ <https://drive.google.com/file/d/1utmAMCmd4rfjHrUfLLfSJ-clpFTjyefl/view>

¹¹ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/our-research/putting-europes-robots-map-automated-journalism-news-agencies>

të integrohet si një grup mjetesh të miratuara që ndihmojnë procesin e punës. Disa nga mjetet që mund të përdoren për këtë qëllim përfshijnë¹²:

- ChatGPT
- Claude
- Perplexity
- NotebookLM
- Otter.ai
- Google Pinpoint
- Fireflies.ai
- Beautiful.ai
- Adobe Firefly
- Apple Intelligence

Megjithatë, është thelbësore të theksohet se asnjëherë Inteligjenca Artificiale nuk duhet të zëvendësojë gazetarin apo gjykimin editorial, por të përdoret si mjet mbështetës për të.

Transkriptimi i intervistave

Një nga format më të zakonshme të përdorimit të Inteligjencës Artificiale në redaksi dhe që lehtëson mjaft punën, është transkriptimi automatik i intervistave audio dhe video ¹³. Mjete si Otter.ai¹⁴, Whisper, Trint, Descript, por edhe alternativa të tjera të ngjashme si Sonix; Happy Scribe, Rev apo Notta, lejojnë që një intervistë e gjatë të ketë edhe tekstin bashkëngjitur në brenda pak minutash.

Në një redaksi tipike, kjo përkthehet në kursim kohe për gazetarin duke e bërë që të ketë më shumë fokus tek analiza dhe shkrimi. Në praktikë, për çdo rast duhet edhe verifikimi manual.

Praktika e shumë redaksive të njohura, por edhe në përditshmërinë tonë tregon se Inteligjenca Artificiale gabon shpesh në emra, shifra, adresa, terma teknikë dhe sidomos në kontekst¹⁵. Prandaj, transkriptimi duhet trajtuar si draft, mbi të cilin do të punohet sërish më pas dhe jo si produkt përfundimtar, i cili publikohet menjëherë¹⁶. Pas draftit të përgatitur nga

¹² <https://www.poynter.org/ethics-trust/2024/how-to-create-newsroom-artificial-intelligence-ethics-policy/>

¹³ <https://cnti.org/reports/ai-transcription-and-translation-in-journalism/>

¹⁴ <https://otter.ai>

¹⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=6fPCf7k69oM>

¹⁶ <https://ijnet.org/en/story/5-ways-science-journalists-can-leverage-ai-their-work>

Inteligjenca Artificiale, gazetari duhet të bëjë një verifikim manual për të konfirmuar që transkriptimi është i njëjtë me atë që është thënë në materialin digjital. Pas kësaj, ndiqen proceset e tjera të prodhimit, publikimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes.

Përkthimi i përmbajtjes

Inteligjenca Artificiale mund përdoret për përkthime të shpejta, sidomos gjatë mbulimit të lajmeve ndërkombëtare. Mjete si DeepL; Google Translate apo edhe LLM si Chat GPT, Gemini, Claude, etj., mundësojnë përkthim të menjëhershëm apo përmbledhje të artikujve, deklaratave apo dokumenteve.

Në praktikë:

- gazetari merr materialin në gjuhë të huaj
- IA prodhon një draft fillestar të materialit të përkthyer
- redaktori verifikon përmbajtjen dhe kontekstin duke e përshtatur atë

Rreziku më i madh në këtë proces është ndryshimi i kuptimit, sidomos në tema politike apo ligjore. Për këtë arsye, përkthimi automatik me IA duhet të pasohet detyrimisht nga redaktimi profesional.

Prodhimi i përmbajtjes dhe hartimi i titujve

Një nga format më të përhapura të përdorimit të Inteligjencës Artificiale në redaksi është asistimi në shkrimin e përmbajtjes. Shembuj të redaksive të ndryshme tregojnë se IA mund të përdoret për të prodhuar drafte të lajmeve, për të përmbledhur informacione nga burime të ndryshme ose për të ndihmuar në strukturimin e tekstit¹⁷.

Në raste konkrete, kjo qasje është përdorur nga media ndërkombëtare për prodhimin e lajmeve të bazuara në të dhëna, si raporte financiare, rezultatet e ndeshjeve, aktivitete të ndryshme sportive, parashikimi i motit apo statistika zyrtare. Në këto raste apo edhe të ngjashme, informacioni është i strukturuar dhe i verifikueshëm, gjë që e bën më të sigurt automatizimin e pjesëve të caktuara të procesit të prodhimit të tij.

Gjithashtu, IA mund të ndihmojë në sugjerimin e titujve alternativë për një artikull, duke ofruar variante që mund të testohen më pas për një ecuri më të mirë në raport me audiencën dhe preferencat e saj. Megjithatë, siç kemi thënë edhe më sipër, redaksitë duhet ta lënë zgjedhjen përfundimtare

¹⁷ <https://emerj.com/automated-journalism-applications/>

në dorën e gazetarit ose redaktorit, i cili vlerëson jo vetëm aspektin teknik, por edhe etik, informativ dhe kontekstual të titullit¹⁸.

Përshtatja e përmbajtjes për rrjete sociale

Inteligjenca Artificiale është një mjet shumë i përdorshëm edhe në përshtatjen e përmbajtjes dhe stilit të komunikimit në varësi të platformës ku ajo do të përdoret.

Një artikull i gjatë, për shembull, mund të përshtatet në disa versione të shkurtra për publikim në platforma të ndryshme, si Facebook, Instagram apo X duke marrë parasysh profilin e audiencës që është aty. Kjo jo vetëm u kursen kohë redaksive, por gjithashtu ndihmon në rritjen e angazhimit të audiencës.

Megjithatë, edhe në këtë rast, është e domosdoshme që përmbajtja të mos deformohet apo të humbasë kuptimin e saj për shkak të optimizimit me qëllim rritjen e angazhimit të audiencës. Integriteti i informacionit duhet të mbetet prioritet i gazetarit/redaktorit përgjegjës për përmbajtjen.

Kur lejohet automatizimi?

Deri më tani kemi folur për automatizimin e proceseve të ndryshme nga mbledhja e informacionit deri te shpërndarja e tij, megjithatë krahas kushtit që vendimin përfundimtar duhet ta marrë një gazetar apo redaktor, ai nuk mund të kryhet për të gjitha historitë që një media publikon.

Automatizimi në gazetari është i pranueshëm në ato raste kur përmbajtja bazohet në të dhëna të strukturuar, të verifikueshme dhe me rrezik të ulët interpretimi. Kjo përfshin, ndër të tjera, raporte statistikore, rezultate zgjedhjesh apo ndeshjesh, parashikimi i motit, të dhëna financiare apo ekonomike, apo dhe informacione të standardizuara¹⁹. Të gjitha këto materiale duhet të jenë të verifikueshme manualisht.

Në këto raste, përdorimi i IA mund të rrisë ndjeshëm shpejtësinë e publikimit dhe të reduktojë ngarkesën e gazetarëve për detyra rutinë, duke u dhënë atyre më shumë kohë për thellimin e analizës dhe investigimit²⁰.

¹⁸ <http://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/ai-adoption-uk-journalists-and-their-newsrooms-surveying-applications-approaches-and-attitudes>

¹⁹ <https://www.mdpi.com/2673-5172/7/1/39>

²⁰ https://www.mediahuis.ie/files/_ireland/files/2022-inma-how-automated-journalism-is-shaping-the-future-of-news-media.pdf

Gjithashtu, automatizimi mund të përdoret si fazë paraprake e prodhimit të përmbajtjes, ku IA gjeneron një draft, i cili më pas rishikohet nga gazetari apo redaktori dhe në fund përgatitet për publikim përfundimtar.

Disa procese nuk mund të automatizohen

Automatizimi i proceseve nuk është i pranueshëm në rastet kur përmbajtja kërkon interpretim, kontekst të thelluar apo qasje editoriale. Kjo përfshin lajme që lidhen me çështje politike, sociale, konflikte, apo tema që prekin individë dhe komunitete në mënyrë të drejtpërdrejtë. Një raportim mbi një konflikt për çështje pronësie nuk është i ngjashëm me një raportim mbi kursin e këmbimit të Lekut me monedhat e tjera sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, përdorimi i IA nuk duhet të zëvendësojë procesin e gjatë dhe të domosdoshëm të verifikimit të informacionit. Nëse një përmbajtje nuk mund të verifikohet plotësisht për saktësinë e saj, nuk duhet të publikohet, pavarësisht se sa i shpejtë mund të jetë publikimi apo sa angazhim të audiencës mund të prodhojë.

Një tjetër kufizim kushtëzohet me transparencën ndaj publikut. Në rastet kur përmbajtja është prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale, audienca duhet të jetë e informuar qartazi për këtë. Në lidhje me këtë, Instituti Shqiptar i Medias ka hartuar një udhëzim të posaçëm që ndihmon redaksitë në përdorimin etik të Inteligjencës Artificiale²¹.

Checklist për verifikim editorial njerëzor

Procesi i domosdoshëm i verifikimit, i përmbajtjeve të prodhuara me ndihmën e Inteligjencës Artificiale duhet të përfshijë disa hapa thelbësorë.

1- Verifikimi i saktësisë së informacionit të përfshirë në përmbajtje. Gazetari verifikon hollësisht nëse të gjitha faktet, shifrat, referencat dhe përfshirja janë të sakta dhe të mbështetura në burime të besueshme.

2- Verifikimi i kontekstit. Problemet e përmbajtjeve të prodhuara me IA i kemi cekur më sipër, prandaj ajo duhet verifikuar nëse reflekton tërësisht realitetin dhe të mos nxjerrë përfundime të gabuara.

3- Identifikimi i paragjytimeve të mundshme. Duhet të vlerësohet nëse përmbajtja e sugjeruar shfaq njëanshmëri apo elemente diskriminuese ndaj grupeve të ndryshme politike, racore, gjinore, etj.

²¹ <https://institutemedia.org/udhezimet-per-perdorimin-etik-te-inteligjences-artificiale-ne-median-shqiptare/>

4- Kontrolli i gjuhës dhe qartësisë së informacionit. Teksti i sugjeruar duhet të jetë i kuptueshëm, i saktë në aspektin gjuhësor dhe në përputhje me stilin dhe qasjen editoriale të medias. Nëse s'është i tillë, duhet të përshtatet sipas këtij modeli.

5- Vendimi editorial. Gazetari ose redaktori duhet të vendosë nëse përmbajtja e sugjeruar i shërben interesit publik apo përmbush kriteret e një lajmi të përshtatshëm për publikim.

Inteligjenca Artificiale mund të shndërrohet nga redaksitë në një mjet të fuqishëm për mbështetjen e procesit gazetaresk, por nuk mund të zëvendësojë rolin e gazetarit.

Si të përdorim Inteligjencën Artificiale në gazetarinë vizuale dhe multimediale

Në një kohë kur përmbajtja vizuale është bërë thelbësore për mënyrën se si audienca e konsumon informacionin, Inteligjenca Artificiale ofron mjete të reja për përpunimin, prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes duke transformuar ndjeshëm edhe gazetarinë vizuale dhe multimediale.

Megjithatë, për shkak të nivelit të lartë të ndikimit që ka imazhi në publik, përdorimi i përgjegjshëm i Inteligjencës Artificiale në këtë zhanër kërkon kujdes dhe përgjegjësi më të madhe profesionale.

Në formën më bazike të përdorimit, programe të ndryshme të Inteligjencës Artificiale si Midjourney, Leonardo, OpenAi, Runway, Synthesia, etj., mund të na ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e materialeve vizuale, për të krijuar ilustrime kur mungojnë pamjet reale, si dhe për të analizuar përmbajtjen multimediale. Në të njëjtën kohë, platforma si Google Vision IA apo InVID ndihmojnë në analizimin dhe verifikimin e përmbajtjes multimediale.

Njëherësh, ajo mbart rreziqe serioze²² që lidhen me manipulimin digjital dhe krijimin e përmbajtjeve të rreme, të cilat mund të cenojnë besimin e publikut ndaj medias, por mund edhe të dëmtojnë imazhin e objekteve të raportimeve nëse përdoren për qëllime që nuk përputhen me interesin publik dhe misionin e medias.

²² <https://blogs.lse.ac.uk/polis/2019/11/18/new-powers-new-responsibilities/>

Përmirësimi i cilësisë së imazheve

Një nga përdorimet më të sigurta dhe më të përhapura të Inteligjencës Artificiale në gazetarinë vizuale është përmirësimi teknik i imazheve. Mjetet e IA mund të përdoren për të rritur rezolucionin e fotografive, për të përmirësuar ndriçimin, për të stabilizuar videot apo për të reduktuar zhurmën në materialet audio dhe vizuale.

Këto ndërhyrje konsiderohen të pranueshme për aq kohë sa nuk ndryshojnë përmbajtjen faktike të imazhit. Qëllimi duhet të jetë gjithmonë përmirësimi i cilësisë teknike dhe jo manipulimi i realitetit.

Kështu, korrigjimi i ndriçimit në një foto është i pranueshëm, por jo heqja ose shtimi i elementeve të tjerë në imazh. Redaksitë duhet të hartojnë rregulla të qarta ku caktohen kufijtë e ndërhyrjes në materialet vizuale duke ruajtur integritetin e informacionin.

Prodhimi i imazheve me IA për qëllime ilustrimi

Platforma të ndryshme të Inteligjencës Artificiale si OpenAi (Chat GPT), Leonardo, Gemini dhe shumë të tjera të ngjashme, bëjnë të mundur krijimin e imazheve nga zero, bazuar në përshkrime tekstuale ose siç quhen në gjuhën teknike, prompt.

Imazhet e prodhuara nga Inteligjenca Artificiale mund të përdoren në gazetari për qëllime ilustrimi, sidomos në rastet kur nuk ekzistojnë pamje reale ose kur tema është abstrakte.

Në artikuj që trajtojnë koncepte si siguria kibernetike, Inteligjenca Artificiale, ekonomia digjitale, përdorimi i imazheve të prodhuara me IA mund të ndihmojë në vizualizimin e përmbajtjes. Kjo vlen edhe për tematika të tjera si raportimi mbi çmimet e ushqimeve, publikimi i recetave të gatimit, etj. Megjithatë, përdorimi i këtyre imazheve kërkon kujdes të veçantë. Ato nuk duhet të përdoren në mënyrë që të krijojnë përshtypjen se janë fotografi reale.

Kufiri midis ilustrimit dhe dokumentimit duhet të jetë i qartë për audiencën dhe forma më e mirë e të bërit të kësaj diference, është shënimi i vendosur nga redaksia që njofton se përmbajtja vizuale është prodhuar me Inteligjencë Artificiale.

Deepfake dhe manipulimi digjital

Një nga sfidat më të mëdha që sjell Inteligjenca Artificiale në gazetarinë vizuale është dukuria e *deepfake* dhe *manipulimit digjital*. Teknologjitë e përparuara mund të krijojnë video, audio apo imazhe që duken plotësisht

reale, por që në fakt janë të fabrikuar. Kjo krijon një rrezik serioz për përhapjen e dezinformimit, pasi përmbajtje të tilla mund të përdoren për të manipuluar opinionin publik, për të dëmtuar reputacionin e individëve, institucioneve, bizneseve apo për të krijuar narrativë të rreme për një çështje të caktuar.

Për median, kjo do të thotë se verifikimi i përmbajtjeve vizuale bëhet po aq i rëndësishëm sa edhe verifikimi i tekstit. Tashmë, nuk mjafton më që një video apo foto të duket autentike, gazetari duhet të verifikojë burimin dhe kontekstin e përdorimit të saj.

Si të shmangim përmbajtjen e pavërtetë të prodhuar nga IA?

Redaksitë në media të ndryshme duhet të adoptojnë disa praktika të qarta verifikimi për të shmangur publikimin e përmbajtjeve të pavërteta të prodhuara nga Inteligjenca Artificiale.

1- Kontrolli i burimit të materialit vizual. Çdo foto apo video që përdoret nga gazetarët duhet të shoqërohet me informacion mbi origjinën e saj dhe, nëse është e mundur, me metadata që konfirmojnë autenticitetin.

2- Përdorimi i mjeteve të verifikimit digjital që ndihmojnë në identifikimin e manipulimeve. Këto mund të përfshijnë analiza e pixel, kontroll të historikut dhe kontekstit të publikimit apo krahasimin me burime të tjera.

3- Qasje skeptike ndaj çdo materiali që duket “shumë i mirë për të qenë i vërtetë”. Në një mjedis ku IA mund të krijojë përmbajtje që mund të ngatërrohen shpesh me realitetin, skepticizmi profesional bëhet një mjet i domosdoshëm.

Etiketimi i përmbajtjes së prodhuar me IA

Inteligjenca Artificiale ofron mundësi të reja për gazetarinë vizuale dhe multimediale, por kërkon një përdorim të kujdesshëm dhe të kontrolluar. Transparenca ndaj audiencës është një nga parimet themelore në përdorimin e saj në gazetari. Kur një imazh, video apo çdo material tjetër multimedial është prodhuar ose modifikuar me ndihmën e IA, redaksia ka detyrimin që ta informojë publikun për këtë gjë.

Etiketimi i qartë i përmbajtjes së prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale ndihmon në ruajtjen e besimit të audiencës dhe shmang keqkuptimet. Informacioni i prodhuar nga sistemet e Inteligjencës Artificiale duhet të identifikohet qartë për audiencat duke përdorur etiketa të tilla

si: “*prodhuar me ndihmën e Inteligjencës Artificiale*”, “*mbështetur nga IA*” ose “*përmbajtje e automatizuar*”.

Në të njëjtën kohë, redaksitë duhet të zhvillojnë politika të brendshme që përcaktojnë kur dhe si duhet të përdoret ky lloj etiketimi, duke siguruar një qasje të njëtrajtshme dhe të përgjegjshme.

Për të rritur transparencën ndaj publikut, redaksitë duhet jo vetëm të shpjegojnë përdorimin e Inteligjencës Artificiale përmes materialeve informuese, por edhe të bëjnë publike politikat e tyre mbi mënyrën se si e përdorin këtë teknologji, në cilat procese editoriale ndërhyjnë dhe si operon në praktikë²³.

Kjo përfshin sqarimin e përdorimit të IA në analiza të audiencës, personalizimin e përmbajtjes apo procese të tjera redaksionale, duke treguar qartë si funksionon teknologjia dhe si trajtohen të dhënat e mbledhura. Një qasje e tillë ndihmon në forcimin e besimit të publikut dhe në kuptimin më të mirë të rolit që IA ka në prodhimin e lajmit.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetarinë investigative

Gazetaria investigative është një nga fushat ku Inteligjenca Artificiale mund të vlejë më shumë në aspektin praktik, veçanërisht në një realitet ku hulumtimet e gazetarëve mbështeten në analiza të thelluara të dhënash, dokumente voluminoze dhe burime të shumta informacioni.

Në këtë realitet, Inteligjenca Artificiale nuk është më thjesht një mjet ndihmës, por një instrument që mund të shndërrojë mënyrën se si zhvillohet një investigim, duke e bërë më të shpejtë dhe me një strukturim më të mirë.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në këtë lëmë të gazetarisë, mund të kryhet në forma shumë konkrete. Një gazetar që po hulumton mbi tendera publike mund të përdorë IA për të analizuar qindra dokumente, për të identifikuar automatikisht emrat e kompanive, fondet limit, ofertat fituese, shkaqet e shkualifikimit dhe lidhjet e mundshme midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë²⁴.

²³ <https://institutemedia.org/wp-content/uploads/2025/10/UDHEZIME-per-PERDORIMIN-ETIK-TE-INTELIGJENCES-ARTIFICIALE-NE-MEDIAN-SHQIPTARE.pdf>

²⁴ <https://www.wired.com/story/panama-papers-data-leak-how-analysed-amount/>

Në vend që gazetari të lexojë manualisht çdo dokument duke mbajtur shënime numrin e faqeve apo paragrafin, IA mund të nxjerrë në pah të gjithë elementet kyç të hulumtimit që ai po bën dhe të sugjerojë modele që kërkojnë hetim më të thelluar.

Shpesh mediat në Shqipëri bëjnë lajme mbi deklaratat e pasurisë së nëpunësve të lartë publik. Prej vitesh, këto të dhëna ofrohen nga ILDKPI në formë digjitale ku secila deklaratë është e ndarë sipas vitit. Në rastet e nëpunësve që kanë vite apo dekada dhe kanë një numër të madh deklaratash, analizimi i plotë i tyre kërkon shumë mund dhe kohë. Ndërkohë, Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në këtë rast dhe të ngjashëm si ky.

Gjatë analizës së të dhënave financiare apo deklaratave të pasurisë, IA mund të ndihmojë në identifikimin e anomalive, si rritje të paarsyetuara të pasurisë, transferime të pazakonta fondesh apo lidhje të përsëritura midis aktorëve të ndryshëm, elementë të cilët mund të identifikohen me vështirësi nga një kontroll manual.

Po ashtu, IA mund të përdoret për të analizuar komunikime të shumta dhe vëllime të mëdha materialesh, si email-e apo dokumente të rrjedhura, siç është parë në vitet e fundit, kur janë zbuluar lidhje të politikanëve apo biznesmenëve vendas me subjekte “*offshore*”.

IA mund të ndihmojë duke grupuar informacionin sipas temave, duke identifikuar fjalë kyçe dhe duke nxjerrë në pah lidhje që nuk janë menjëherë të dukshme. Në këtë mënyrë, procesi i kërkimit bëhet më efikas dhe më i fokusuar.

Pavarësisht këtyre avantazheve, përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetarinë hulumtuuese kërkon një balancë të kujdesshme midis efikasitetit dhe rigorozitetit profesional. Çdo rezultat i prodhuar nga IA duhet të trajtohet si një indicie dhe jo si një fakt i verifikuar. Verifikimi, kontekstualizimi dhe interpretimi mbeten përgjegjësi ekskluzive e gazetarit.

Nxjerrja e të dhënave nga burime të hapura

Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë ndjeshëm në mbledhjen dhe strukturimin e të dhënave nga burime të hapura duke përfshirë faqe zyrtare, databaza publike, rrjete sociale dhe dokumente të publikuara online. Në vend që gazetari të kërkojë manualisht në dhjetëra burime, IA mund të automatizojë këtë proces, të organizojë informacionin dhe të ndihmojë në identifikimin e lidhjeve mes të dhënave të ndryshme ²⁵.

²⁵ <https://www.ibm.com/think/insights/ai-in-journalism>

Në praktikë, kjo mund të aplikohet në shumë mënyra konkrete. Një gazetar që ndjek zhvillimet në sektorin e shëndetësisë mund të përdorë IA për të mbledhur dhe krahasuar të dhëna nga raportet mujore të spitaleve, duke identifikuar ndryshime në numrin e pacientëve, mungesat e barnave apo prirje të caktuara në sëmundshmëri.

Në një rast tjetër, gjatë monitorimit të rrjeteve sociale, IA mund të analizojë mijëra postime dhe komente për të identifikuar tema që po marrin vëmendje të madhe publike, duke ndihmuar gazetarin të kuptojë më shpejt reagimin e qytetarëve ndaj një ngjarjeje apo politike të caktuar.

Po ashtu, në mbulimin e çështjeve ekonomike, një gazetar mund të përdorë IA për të mbledhur të dhëna nga publikime të ndryshme zyrtare, si statistika të punësimit apo çmimeve, dhe për t'i krahasuar ato në kohë, duke nxjerrë në pah rritje, ulje apo ndryshime të rëndësishme²⁶.

Një përdorim tjetër praktik është në ndjekjen e aktivitetit të institucioneve publike, ku IA mund të mbledhë automatikisht njoftime, vendime apo publikime të reja dhe t'i organizojë ato sipas temës, duke krijuar një panoramë të qartë të veprimtarisë së tyre.

Identifikimi i modeleve dhe tendencave

Një nga përdorimet më konkrete të Inteligjencës Artificiale është aftësia për të identifikuar modele dhe tendenca në të dhëna që nuk dallohen lehtësisht përmes analizës manuale. Në praktikë, kjo nënkupton se IA mund të ndihmojë gazetarët të evidentojnë lidhje, përsëritje apo ndryshime në kohë, të cilat në kundërt do të kërkonin procese analize të gjata dhe komplekse.

Gjatë raportimeve për ecurinë e çmimeve në tregje, një gazetar mund të përdorë Inteligjencën Artificiale për të analizuar lëvizjen e çmimeve të produkteve bazë gjatë muajve ose viteve, duke identifikuar rritje të pazakonta në periudha të caktuara apo sjellje të ngjashme midis operatorëve të ndryshëm të tregut.

Po ashtu, nëse një gazetar do të raportojë për çështje të sigurisë rrugore Inteligjenca Artificiale mund të analizojë të dhëna të shumta mbi aksidentet për të identifikuar zona me rrezik të lartë, orare kur ndodhin më shpesh apo faktorë të përsëritur që ndikojnë në to.

²⁶ https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/02/intellectual-property-issues-in-artificial-intelligence-trained-on-scraped-data_a07f010b/d5241a23-en.pdf

Një përdorim tjetër konkret është në analizën e përmbajtjes së rrjeteve sociale, ku IA mund të identifikojë se si përhapet një narrativë, cilët janë përdoruesit më aktivë dhe si evoluon një temë e caktuar nga dita në dite duke marrë indicie të ndryshme, të cilat më pas duhet t'i vlerësojë vetë nëse janë çështje mbi të cilat mund të hulumtojë më te ose jo.

Parandalimi i përmbajtjeve të pavërteta të prodhuara nga IA

Krahas lehtësirave të shumta që kemi paraqitur më sipër, përdorimi i Inteligjencës Artificiale shoqërohet me rrezikun që sistemi të prodhojë përfundime të pasakta, të sajura ose të pambështetura në fakte reale. Shpesh këto rezultate paraqiten në formë bindëse, me gjuhë të sigurt dhe strukturë logjike, madje edhe referenca të stisura, gjë që i bën më të vështira për t'u dalluar si të gabuara.

Duhet parasysh që sistemet LLM si ChatGPT njihen për sjellje “*halucinante*” dhe zakonisht nuk dinë të thonë “*nuk e di këtë çështje*”, por përpiqen të stisin një përgjigje edhe kur nuk ka të dhëna të verifikueshme për tematikën në fjalë^{27,28}.

Ndodh jo rrallë kur një platformë e IA përmbledh një raport dhe i atribuon një institucioni të caktuar përfundime që në të vërtetë nuk ndodhen në tekstin origjinal, ose kur lidh dy të dhëna të ndara dhe paraqet një marrëdhënie shkak-pasojë që, faktikisht, nuk është e provuar.

Nisur nga sa më sipër, mund të thuhet se Inteligjenca Artificiale e pamonitoruar nga një gazetar profesionist mund të prodhojë referenca, citime apo statistika që duken të sakta, por që nuk ekzistojnë realisht.

Në rastet kur një gazetar përdor Inteligjencën Artificiale për të analizuar një raport auditimi të një institucioni apo biznesi të caktuar, ekziston rreziku që sistemi ta paraqesë si “gjetje kryesore” një çështje që në dokument përmendet vetëm si dyshim paraprak dhe jo si përfundim zyrtar.

Në një rast tjetër, gjatë përmbledhjes së një dosjeje me dokumente, Inteligjenca Artificiale mund të bashkojë informacione nga periudha të ndryshme dhe të krijojë një narrativë që duket koherente, por që nuk përputhet me rendin real të ngjarjeve.

Për këtë arsye pas çdo përdorimi të IA-së, gazetari duhet të kthehet gjithmonë te dokumenti origjinal, të kontrollojë burimin, të krahasojë

²⁷ <https://www.ibm.com/think/topics/ai-hallucinations>

²⁸ <https://arxiv.org/abs/2304.13734>

të dhënat me materiale të tjera të pavarura dhe të mos mbështetet te përmbledhja automatike si bazë e vetme për raportim.

Verifikimi mund të bëhet duke kaluar nëpër tre procese kontrolli: (1) Verifikimi dhe krahasimi me burimin origjinal; (2) konfirmimi me një burim të dytë të pavarur dhe (3) verifikimi i kontekstit. Vetëm pas këtij procesi, informacioni mund të përdoret në mënyrë të sigurt në raportim.

Dokumentimi i përdorimit të IA në procesin hulumtues

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale gjatë një procesi gazetaresk duhet të jetë i gjurmueshëm në çdo hap. Kjo do të thotë që media dhe gazetari jo vetëm që duhet të njoftojë audiencën që e ka përdorur, por edhe të tregojë në mënyrë të dokumentuar se si e ka përdorur atë gjatë procesit të mbledhjes, përpunimit, prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit²⁹. Dokumentimi mund të realizohet përmes një dosjeje të posaçme të përmbajtjes mbi të cilën po punohet, ku ruhen elementë specifikë si³⁰:

- cili është mjeti IA i përdorur;
- për çfarë qëllimi konkret është përdorur (përmbledhje dokumentesh, analizë të dhënash, kërkim informacioni, etj);
- cilat të dhëna janë futur në sistem;
- çfarë rezultatesh ka prodhuar IA?

Nëse gjatë një hulumtimi është përdorur IA për të analizuar një numër të madh dokumentesh, gazetari duhet të ruajë: Prompt-in që i është dhënë sistemit; përgjigjen e plotë të IA dhe mënyrën se si kjo përgjigje është përdorur në përmbajtjen e publikuar.

Në një rast tjetër, nëse IA përdoret për të përmbledhur një raport të gjatë, redaksia duhet të dokumentojë se cilat pjesë të përmbledhjes janë verifikuar dhe krahasuar me burimin origjinal, dhe çfarë ndryshimesh janë bërë gjatë verifikimit. Ky dokumentim shërben për disa qëllime konkrete.

- Së pari, krijon një gjurmë të qartë të procesit, që mund të rishikohet nga redaktorët ose në rast kontestimi publik.
- Së dyti, ndihmon në identifikimin e gabimeve dhe përmirësimin e praktikave në të ardhmen.
- Së treti, forcon llogaridhënien brenda redaksisë.

²⁹ <https://www.theajp.org/news-insights/insights/developing-an-ai-usage-policy-in-your-news-organization>

³⁰ <https://www.theajp.org/news-insights/insights/developing-an-ai-usage-policy-in-your-news-organization>

Në rastet kur përdorimi i IA ka rol të rëndësishëm në ndërtimin e historisë, një pjesë e këtij dokumentimi mund të bëhet publik në formë të thjeshtuar, përmes një shënimi editorial që shpjegon si është përdorur teknologjia.

Si të përdorim IA për verifikimin e fakteve?

Në një mjedis informativ gjithnjë e më kompleks, ku përmbajtja prodhohet me shpejtësi dhe shpërndahet me kosto thuajse zero, Inteligjenca Artificiale mund të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për të mbështetur procesin e verifikimit të fakteve.

Në një mjedis informativ ku përmbajtja prodhohet dhe shpërndahet me shpejtësi të lartë, Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në verifikimin e fakteve duke përshpejtuar kërkimin, krahasimin dhe kontrollin e të dhënave³¹. Roli i saj nuk është të vendosë se çfarë është e vërtetë, por të ndihmojë gazetarin të arrijë më shpejt te burimet dhe të identifikojë mospërputhje në informacion.

Një përdorim konkret është verifikimi i shifrave dhe të dhënave statistikore. Kur një artikull përmend të dhëna mbi inflacionin, popullsinë apo tregues të tjerë ekonomikë, IA mund të përdoret për të krahasuar menjëherë këto shifra me burime zyrtare si raportet e institucioneve apo databazat publike, duke evidentuar nëse ato përputhen apo jo³².

Një tjetër rast praktik është kontrolli i fakteve kronologjike. Nëse një ngjarje paraqitet me një rend të caktuar zhvillimesh, IA mund të ndihmojë në rindërtimin e kronologjisë përmes analizës së publikimeve të mëparshme, duke nxjerrë në pah nëse ka mospërputhje në të dhëna, renditjen apo përshkrimin e ngjarjeve.

Po ashtu, në rastet kur një lajm mbështetet në dokumente, IA mund të përdoret për të kontrolluar nëse përmbajtja e raportuar përputhet me dokumentin origjinal. Nëse një raport përmend një konkluzion të caktuar, IA mund të ndihmojë në gjetjen e seksionit përkatës në dokument për të verifikuar nëse ai konkluzion është interpretuar saktë.

Në fushën vizuale, Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në verifikimin e materialeve duke analizuar nëse një imazh është publikuar më parë, nëse është modifikuar apo nëse i përket një konteksti tjetër nga ai që pretendohet.

³¹ <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000384551>

³² <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000384551>

Gjithashtu, IA mund të përdoret për të krahasuar versione të ndryshme të të njëjtit informacion të publikuar nga burime të ndryshme, duke identifikuar dallime në përmbajtje, shifra apo interpretim, çka ndihmon gazetarin të kuptojë se ku mund të qëndrojë pasaktësia.

Verifikimi i citimeve dhe deklaratave

Një përdorim konkret i Inteligjencës Artificiale në verifikimin e fakteve është kontrolli i shpejtë i deklaratave publike. Kur një politikan publikon një shifër mbi ekonominë apo punësimin, gazetari mund të përdorë IA për të gjetur menjëherë raportet përkatëse të institucioneve përgjegjëse, për të krahasuar shifrën me të dhënat zyrtare dhe për të parë nëse pretendimi është i saktë, është thënë si një gjysmë e vërtetë apo është i gënjeshtërt.

Një tjetër rast praktik është verifikimi i citimeve. Nëse një deklaratë qarkullon në rrjete sociale apo media të tjera online, IA mund të ndihmojë në gjetjen e burimit original, duke analizuar intervista, artikuj apo video për të verifikuar nëse deklarata e cituar është e saktë apo e gabuar.

Po ashtu, në situata me volum të madh informacioni, si konferenca për shtyp apo debate publike, IA mund të përdoret për të transkriptuar dhe analizuar automatikisht përmbajtjen, duke identifikuar deklaratat kryesore që kërkojnë verifikim. Në fushën vizuale, IA mund të ndihmojë në kontrollin e imazheve apo videove duke krahasuar materiale të ngjashme në internet, duke analizuar metadata ose duke identifikuar nëse një pamje është përdorur më parë në një kontekst tjetër.

Verifikimi i imazheve dhe materialeve audiovizive

Verifikimi i përmbajtjes vizuale është një nga proceset më kritike në gazetari, pasi imazhet dhe videot ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si audienca e percepton një ngjarje. Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë në këtë proces kompleks duke analizuar elemente që nuk dallohen lehtësisht me sy të lirë.

Një formë përdorimi konkret është kontrolli nëse një imazh i publikuar në rrjetet sociale apo mediat online, është përdorur më parë³³. Nëse një foto pretendohet se është nga një ngjarje e fundit, IA mund të ndihmojë në gjetjen e versioneve të mëparshme të së njëjtës foto në internet, duke zbuluar kontekstin e përdorimit të saj në publikime të mëparshme, javë, muaj apo ndoshta vite më parë³⁴.

³³ <https://fullfact.ai>

³⁴ <https://fullfact.ai>

Një tjetër rast është verifikimi i vendndodhjes së një videoje. Nëse një video pretendohet se është filmuar në një qytet të caktuar, IA mund të ndihmojë në analizimin e elementeve vizuale si ndërtesat, rrugët, sinjalistika apo peizazhi, dhe në krahasimin e tyre me imazhe të njohura nga ai vend, për të parë nëse përputhen me peizazhin e një rruge, fshati apo qyteti të caktuar.

Në rastet e manipulimit digjital, IA mund të identifikojë ndërhyrje në imazh, si kërcitje në ndriçim, deformime të strukturës apo elemente që nuk përputhen me pjesën tjetër të fotos. Në një foto ku janë shtuar ose hequr persona, mjetet analitike mund të zbulojnë mospërputhje në hijet, reflektimet apo cilësinë e pikselëve.

Sa i përket materialeve video, IA mund të ndihmojë në analizimin e audios dhe imazhit për të kuptuar nëse ka ndërprerje, montazh apo sinkronizim të pasaktë mes zërit dhe figurës, që mund të sinjalojnë për ndonjë manipulim të mundshëm.

Në çdo rast, këto analiza duhet të shoqërohen gjithmonë me kontroll manual nga gazetari apo eksperti i fushës që redaksia përdor për raste të tilla, nëse do të bëhet një krahasim në aspektin teknik³⁵. Gazetari duhet të kërkojë burimin original të materialit, të kontaktojë autorin nëse është e mundur dhe të krahasojë informacionin me burime të tjera të pavarura.

Kufizimet e IA në verifikimin e fakteve

Pavarësisht se mund të përshpejtojë ndjeshëm procesin e verifikimit, Inteligjenca Artificiale ka kufizime të dukshme që kërkojnë kujdes maksimal në përdorim.

Një problem që haset rëndom është prodhimi i përgjigjeve që duken të sakta, por që nuk mbështeten në burime reale. Gjatë kërkimeve për të verifikuar një statistikë, Inteligjenca Artificiale mund të japë një shifër shumë specifike dhe të besueshme, por pa qenë në gjendje të tregojë burimin e saktë ose duke iu referuar një raporti që në fakt nuk ekziston.

Një tjetër kufizim shfaqet në përpunimin e informacionit kompleks. Nëse një lajm përmban të dhëna të përziera nga disa burime, IA mund t'i bashkojë ato në një përmbledhje që duket logjike, por që përzien kontekste të ndryshme dhe krijon një interpretim të pasaktë³⁶. IA mund të paraqesë

³⁵ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/our-research/understanding-promise-and-limits-automated-fact-checking>

³⁶ <https://artificialintelligenceact.eu/article/14/>

një shifër të para një viti si aktuale, duke mos dalluar ndryshimet kohore.

Në rastin e përmbajtjes vizuale, IA ka herë pas here vështirësi të dallojë materiale të manipuluar në mënyrë të avancuar. Një video deepfake e realizuar mirë mund të mos identifikohet si e rreme vetëm nga analizat automatike, sidomos nëse nuk ka elemente të dukshme teknike që e tradhtojnë manipulimin.

Gjithashtu, një kufizim tjetër është mungesa e transparencës në mënyrën se si platformat e Inteligjencës Artificiale arrijnë në një përfundim kur ne pyesim për diçka. Kur një sistem jep një përgjigje, gazetari nuk ka gjithmonë akses në procesin që ka ndjekur për të arritur aty, çka e bën të vështirë të vlerësohet nëse informacioni është i besueshëm apo jo.

Ndërkohë, Inteligjenca Artificiale nuk jep “të vërtetën absolute”, por një përgjigje që sistemi e ka përzgjedhur si më të mundshmen mes shumë alternativave. Ndryshe nga kërkimi në Google, që ofron disa burime për krahasim, IA paraqet zakonisht vetëm një version të përpunuar të informacionit.

Rreziku bëhet më i dukshëm kur IA analizon dokumente dhe nxjerr një përfundim “kryesor”. Ky përfundim mund të jetë interpretim i përgjithshëm dhe jo një fakt i shprehur qartë në tekst, çka mund të çojë në keqinformim nëse merret si i mirëqenë pa verifikim.

Kombinimi i IA me metodat tradicionale të verifikimit

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në rastet e përdorimit gjatë procesit të verifikimit të informacionit, funksionon më mirë kur kombinohet drejtpërdrejt me proceset klasike të gazetarisë. IA mund të ndihmojë në gjetjen e informacionit dhe në organizimin e tij, por verifikimi final kërkon gjithmonë ndërhyrje njerëzore.

Nëse një gazetar përdor IA për të gjetur një statistikë apo raport zyrtar, hapi i radhës nuk është publikimi, por verifikimi i dokumentit original dhe krahasimi i tij me të dhënat e ofruara nga IA si edhe burime të tjera të pavarura. IA mund ta gjejë raportin brenda pak sekondave, por gazetari duhet të konfirmojë nëse shifra është në dokument dhe po ashtu nëse është interpretuar saktë.

Në një rast tjetër, nëse Inteligjenca Artificiale sugjeron se një ngjarje ka ndodhur në një datë të caktuar, gazetari duhet të verifikojë këtë informacion përmes burimeve arkivore të medias apo burimeve të hapura për të shmangur gabimet në kronologji.

Po ashtu, në rastet kur IA ndihmon në analizimin e një materiali të madh, si një raport apo databazë, gazetari duhet të rikthehet te pjesët konkrete të dokumentit për të parë nëse përfundimet që sugjeron IA janë të mbështetura realisht në tekst.

Një praktikë tjetër konkrete është kombinimi i të dhënave nga IA me verifikimin në terren³⁷. Edhe nëse IA ndihmon në identifikimin e një fakti apo piste të caktuar për një ngjarje, konfirmimi përfundimtar mund të kërkojë kontakt me institucione, ekspertë apo persona të përfshirë drejtpërdrejt.

Kombinimi i këtyre dy qasjeve krijon një proces më të fortë: teknologjia ndihmon në efikasitet, ndërsa gazetaria tradicionale garanton saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit.

Inteligjenca Artificiale në analizën e trendeve dhe menaxhimin e audiencës

Inteligjenca Artificiale i jep medias mundësinë të kuptojë në kohë reale se çfarë po lexon publiku, si po reagon dhe cilat tema po marrin më shumë vëmendje. Kjo bëhet përmes analizës së të dhënave si klikimet, koha e qëndrimit në artikull, harta e kalimit nga njëri artikull në tjetrin, shpërndarjet në rrjete sociale apo komentet e lexuesve³⁸.

Një redaksi mund të përdorë IA për të identifikuar se një artikull mbi çmimin e karburanteve po lexohet shumë më tepër se të tjerët dhe po shpërndahet intensivisht në rrjete sociale. Në këtë rast, redaksia mund të vendosë të ndjekë temën me materiale të tjera shpjeguese, analiza apo intervista, duke iu përgjigjur drejtpërdrejt interesit të audiencës.

Një tjetër përdorim konkret është identifikimi i trendeve në kohë. IA mund të analizojë se cilat tema po rriten gradualisht në interes, për shembull një çështje ekonomike apo sociale që fillimisht kalon pa shumë vëmendje, por më pas fillon të marrë reagim më të gjerë. Kjo i jep redaksisë mundësinë të hyjë më herët se konkurrentët mediatikë në një histori dhe ta trajtojë atë në mënyrë më të thelluar.

Po ashtu, në menaxhimin e audiencës, IA mund të përdoret për të kuptuar llojet e përmbajtjes që funksionojnë më mirë për grupe të ndryshme lexuesish. Disa lexues mund të preferojnë artikuj të shkurtër dhe të drejtpërdrejtë, ndërsa të tjerë analiza më të gjata. Bazuar në këtë të

³⁷ <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000384551>

³⁸ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/ai-journalism-future-news>

dhënë nga IA, redaksia mund të përshtatë mënyrën e prezantimit të lajmit pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore.

Një përdorim tjetër konkret është në shpërndarjen e përmbajtjes. IA mund të ndihmojë në përcaktimin e kohës më të përshtatshme për publikim apo në sugjerimin e artikujve të lidhur, duke rritur mundësinë që lajmi të arrijë më shumë lexues.

Megjithatë, përdorimi i këtyre mjeteve kërkon përgjegjësi dhe vëmendje ndaj parimeve gazetareske dhe interesit publik, sepse jo gjithçka që është interesante për audiencën është në interes të publikut.

Nëse redaksia ndjek vetëm lajmin që “performon”, ekziston rreziku që të favorizohen tema sensacionale kundrejt tematikave me peshë, duke lënë në hije çështje me interes publik që mund të mos gjenerojnë angazhime të mëdha të audiencës në mënyrë të menjëhershme.

Personalizimi i përmbajtjes

Personalizimi i përmbajtjes do të thotë që lexues të ndryshëm shohin përmbajtje të ndryshme, bazuar në sjelljen e tyre në platformë. Inteligjenca Artificiale analizon çfarë artikujsh lexon një përdorues, sa kohë qëndron në to dhe çfarë shpërndan, për të sugjeruar materiale të ngjashme³⁹.

Nëse një lexues kalon më shumë kohë duke lexuar lajme për ekonomi dhe biznes, sistemi mund t’i rekomandojë automatikisht artikuj të tjerë mbi inflacionin, tregun e punës apo investimet. Ndërkohë, një përdorues tjetër që ndjek më shumë lajme sociale mund të shohë në faqen kryesore përmbajtje të fokusuar në çështje sociale apo komunitare⁴⁰.

Një përdorim konkret është në faqet e medias ku shfaqen seksione si “Artikuj të rekomanduar për ju” ose “Lexo gjithashtu”, ku IA sugjeron përmbajtje bazuar në historikun e leximit. Po ashtu, në rrjete sociale, algoritmet vendosin cilat lajme t’i shfaqen më shpesh një përdoruesi, duke ndikuar drejtpërdrejt në informacionin që ai konsumon.

Në rrjetet sociale kjo gjë menaxhohet nga algoritmet, të cilët bëjnë një personalizim të mirëfilltë të përmbajtjes, ndërkohë që në WEB kjo mund të bëhet përmes instalimit të “shtojcave” të ndryshme, të cilat bëjnë që përmbajtje të ndryshme t’u shërbehen audiencave të ndryshme në varësi të sjelljes së tyre në WEB.

³⁹ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/digital-news-report/2025/how-audiences-think-about-news-personalisation-ai-era>

⁴⁰ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/digital-news-report/2025>

Por, ky mekanizëm ka edhe rreziqe⁴¹. Nëse një përdorues ekspozohet vetëm ndaj temave që i interesojnë ose që përputhen me bindjet e tij, ai mund të mos shohë këndvështrime të tjera. Një lexues që ndjek vazhdimisht vetëm një linjë të caktuar lajmesh mund të mos ekspozohet ndaj analizave alternative apo informacioneve që sfidojnë mendimin e tij.

Ky rrezik ka sjellë në vëmendje, në kohërat e sotme, edhe nevojën e reformimit të logjikës së algoritmeve, të cilat sipas ekspertëve që mbështesin këtë ide, nuk duhet të shërbejnë vetëm përmbajtjet me të cilat audiencia angazhohet më shumë online, por edhe duhet ta ekspozojë audiencën qëllimisht ndaj përmbajtjesh që shkojnë në kah të kundërt me idetë e tyre.

Nisur nga këto problematika të hasura, redaksitë duhet të vendosin kufij praktikë në drejtim të personalizimit të përmbajtjes, e cila nuk duhet që të kufizojë mendimet alternativa për audiencat⁴². Një qasje e balancuar mund të jetë që, krahas përmbajtjes së personalizuar, përdoruesve t'u shfaqen edhe lajme me rëndësi të përgjithshme, si zhvillime politike, ekonomike apo sociale që kanë interes publik, pavarësisht preferencave individuale⁴³. Në këtë mënyrë, Inteligjenca Artificiale ndihmon në përmirësimin e eksperiencës së lexuesit, por pa kufizuar aksesin e tij në një informacion të plotë dhe të larmishëm.

Identifikimi i gjuhës së urrejtjes dhe abuzimit

Inteligjenca Artificiale nuk përdoret vetëm për moderimin e komenteve të audiencës, por edhe si një mjet kontrolli për përmbajtjen që prodhon vetë redaksia, për të shmangur publikimin e materialeve me gjuhë problematike, paragjyquese apo diskriminuese.

Në praktikë, në nivelin e audiencës, IA mund të analizojë automatikisht komentet dhe reagimet, duke identifikuar gjuhë fyese, kërcënuese apo diskriminuese⁴⁴. Në një artikull me interes të lartë publik, ku gjenerohen qindra komente, sistemi mund të filtrojë menjëherë përmbajtjet më

⁴¹ https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2023/06/consumer-vulnerability-in-the-digital-age_85b498eb/4d013cc5-en.pdf

⁴² <https://academic.oup.com/pnasnexus/article/3/12/pgae518/7904735>

⁴³ <https://jolt.law.harvard.edu/assets/articlePDFs/v372/3-The-Meta-Oversight-Board-and-the-Empty-Promise-of-Legitimacy.pdf>

⁴⁴ <https://www.ft.com/content/3880176e-d3ac-4311-9052-fdfeaed56a0e?syn-25a6b1a6=1>

problematike dhe t'i kalojë për shqyrtim nga moderatorët, duke reduktuar ndjeshëm ngarkesën manuale⁴⁵.

Por një përdorim po aq i rëndësishëm është brenda redaksisë. Para publikimit, IA mund të përdoret për të analizuar tekstin e një artikulli dhe për të identifikuar formulime që mund të interpretohen si paragjyquese, stigmatizuese apo të njëanshme. Në raportimin për grupe të caktuara sociale, sistemi mund të sinjalizojë përdorimin e termave që kanë konotacion negativ ose që nuk janë në përputhje me standardet etike të raportimit.

Në një rast tjetër, gjatë përgatitjes së titujve, IA mund të ndihmojë në identifikimin e formulimeve sensacionaliste apo nxitëse, që mund të përkeqësojnë gjuhën e urrejtjes në hapësirën publike. Kjo i jep redaksisë mundësinë të rishikojë tonin dhe mënyrën e paraqitjes përpara publikimit.

Po ashtu, në përmbajtjet multimediale, IA mund të analizojë transkriptimet e videove apo podcasteve për të identifikuar deklarata që mund të përbëjnë gjuhë abuzive ose të nxisin diskriminim, duke ndihmuar në korrigjimin e tyre përpara publikimit, të cilat më pas mund të verifikohen manualisht nga një gazetar apo redaktor që do të vendosë se si do të veprohet me to.

Ruajtja e lirisë së shprehjes

Automatizimi i procesit të moderimit të përmbajtjes para publikimit apo të reagimeve të audiencës përbën një sfidë të madhe për mediat, të cilat duhet të filtrojnë përmbajtjet problematike nga njëra anë por edhe duhet të nxisin, raportimin kritik, debatin dhe qëndrimet e ndryshme nga ana tjetër.

Nëse sistemet automatike vendosin pa patur kontroll njerëzor, ekziston rreziku që të bllokohen edhe mendime kritike, analiza apo qëndrime të forta që janë pjesë normale e debatit publik.

Një koment kritik ndaj një institucioni mund të përmbajë gjuhë të ashpër, por jo domosdoshmërisht të jetë abuziv. Një sistem automatik IA mund ta klasifikojë gabimisht si përmbajtje problematike dhe ta fshijë, duke kufizuar ide që mund të ndihmojnë në debatin publik⁴⁶.

⁴⁵ <https://help.nytimes.com/115014792387-The-Comments-Section>

⁴⁶ <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/digital-news-report/2025/dnr-executive-summary>

Po ashtu, një artikull investigativ që përdor citime të forta ose përshkrime të drejtpërdrejta mund të sinjalizohet si “i rrezikshëm”, edhe pse është në përputhje me standardet gazetareske⁴⁷.

Për të shmangur këto raste, redaksitë duhet të vendosin rregulla të qarta praktike. IA mund të përdoret për të shënuar automatikisht përmbajtjet e dyshimta, por jo për t'i fshirë ato pa u parë nga një redaktor. Facebook e përdor këtë në rastet e moderimit të përmbajtjes në grupe⁴⁸, ku sistemi fshin automatikisht përmbajtjet abuzive por edhe sinjalizon administratorët e grupit në rastet kur ajo është në kufij.

Një tjetër masë konkrete është diferencimi i nivelit të ndërhyrjes. Përmbajtjet që përmbajnë kërcënime të drejtpërdrejta mund të bllokohen menjëherë, ndërsa ato që janë në kufi mes kritikës dhe abuzimit mund të kalojnë për vlerësim manual nga gazetarët apo redaktorët.

Po ashtu, redaksitë mund të përdorin IA për të analizuar tendencat e moderimit, për shembull nëse një lloj i caktuar komentesh po bllokohet më shpesh se të tjerat, duke identifikuar nëse sistemi po kufizon padrejtësisht një kategori të caktuar mendimesh.

Kështu, Inteligjenca Artificiale shihet si një filtër i parë, që ndihmon në identifikimin e problemeve, por jo si një mekanizëm që vendos përfundimisht çfarë lejohet dhe çfarë jo.

Menaxhimi i Rreziqeve

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetari, krahas mundësive të reja sjell edhe rreziqe që duhet të menaxhohen me kujdes. Disa nga këto rreziqe lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin e burimeve gazetareske dhe respektimin e të drejtave të autorit.

Media dhe gazetarët që përdorin Inteligjencën Artificiale duhet të jenë të vetëdijshme se shumë prej mjeteve të IA funksionojnë përmes përpunimit të dhënave në platforma të jashtme. Në disa raste, informacioni i futur në këto sisteme mund të ruhet ose të përdoret për trajnimin e mëtejshëm të algoritmeve, në të cilat bazohet funksionimi i platformës. Për këtë arsye, përdorimi i tyre kërkon kujdes të veçantë dhe rregulla të qarta. Kjo pjesë

⁴⁷ <https://www.reuters.com/business/media-telecom/ai-assistants-make-widespread-errors-about-news-new-research-shows-2025-10-21/>

⁴⁸ <https://transparency.meta.com/en-gb/enforcement/>

e manualit trajton dy fusha kryesore të rrezikut: mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave, si dhe respektimin e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale.

Si të mbrojmë privatësinë dhe të dhënat?

Mbrojtja e të dhënave personale dhe e informacionit konfidencial është një nga përgjegjësitë kryesore të gazetarisë profesionale. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale mund të krijojë rreziqe të reja në këtë drejtim, veçanërisht kur përdoren platforma të jashtme që përpunojnë informacionin e futur nga përdoruesit. Për këtë arsye, media dhe vetë gazetarët duhet të zhvillojnë praktika të qarta për mënyrën se si përdoren mjetet e IA dhe çfarë lloj informacioni mund të futet në to.

Të dhënat që nuk duhet të futen në mjetet e IA

Një nga parimet bazë të përdorimit të Inteligjencës Artificiale është që informacioni sensitiv të mos futet në sisteme që nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të redaksisë. Në veçanti, gazetarët duhet të shmangin futjen në mjetet e IA të:

- të dhënave personale të individëve që nuk janë publike
- informacionit konfidencial që lidhet me burimet gazetareske
- dokumenteve të brendshme të redaksisë
- materialeve draft, që akoma nuk janë publikuar
- informacionit që mund të cenojë privatësinë e individëve

Edhe kur një mjet IA përdoret vetëm për përpunim teknik, si për shembull për përmbledhjen ose analizën e dokumenteve, duhet të vlerësohet nëse platforma ruan ose përdor të dhënat e futura nga përdoruesit.

Shumë platforma të Inteligjencës Artificiale funksionojnë përmes serverëve të jashtëm. Në disa raste, të dhënat e futura nga përdoruesit mund të ruhen ose të përdoren për përmirësimin e sistemit. Kjo krijon një rrezik potencial për rrjedhjen e informacionit, sidomos kur bëhet fjalë për materiale të ndjeshme ose për informacion që lidhet me burime konfidenciale. Redaksitë duhet të vlerësojnë me kujdes kushtet e përdorimit të platformave të IA dhe të përcaktojnë qartë se cilat mjete janë të autorizuara për përdorim brenda redaksisë.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në media duhet të jetë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Shqipëria ka një kuadër të plotë për mbrojtjen e të dhënave personale, që përfshin ligjin dhe institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky kuadër ligjor synon të mbrojë privatësinë e individëve dhe të rregullojë mënyrën se si organizatat përpunojnë informacionin personal. Media dhe gazetarët duhet të sigurohen që përdorimi i teknologjive të IA të respektojë rregullat për:

- përpunimin e të dhënave personale
- ruajtjen dhe sigurinë e informacionit
- përdorimin e të dhënave nga palë të treta

Në rastet kur përdoren platforma të jashtme të IA, është e rëndësishme të kuptohet se ku ruhen të dhënat dhe kush ka akses në to. Në këtë pikë mund të ketë mungesë transparence nga ana e platformave të IA.

Mbrojtja e burimeve gazetareske

Mbrojtja e burimeve është një nga parimet themelore të gazetarisë. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale nuk duhet të rrezikojë konfidencialitetin e burimeve që japin informacion për interes publik. Gazetarët duhet të shmangin futjen në sistemet e IA të çdo informacioni që mund të identifikojë një burim konfidencial. Edhe detaje të vogla mund të jenë të mjaftueshme për të zbuluar identitetin e një burimi.

Për këtë arsye, çdo përdorim i Inteligjencës Artificiale që përfshin analiza dokumentesh ose përpunim informacioni duhet të bëhet me kujdes të veçantë kur bëhet fjalë për materiale sensitive.

Si të mbrojmë të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale?

Inteligjenca Artificiale mund të gjenerojë tekste, imazhe dhe materiale të tjera që duken si përmbajtje origjinale. Megjithatë, në shumë raste këto rezultate bazohen në analiza të materialeve ekzistuese që janë përdorur për të trajnuar sistemet e IA. Kjo krijon sfida të reja për gazetarinë, veçanërisht në lidhje me plagjiaturën, pronësinë e përmbajtjes dhe transparencën ndaj publikut.

Parandalimi i plagjiaturës

Gazetarët dhe redaksitë duhet të jenë të kujdesshëm kur përdorin Inteligjencën Artificiale për të prodhuar ose përpunuar përmbajtje. Edhe nëse një tekst prodhohet nga një sistem IA, është e rëndësishme të verifikohet nëse ai përmban fragmente që mund të jenë të ngjashme me materiale ekzistuese. Redaksitë duhet të mbajnë të njëjtat standarde të integritetit editorial edhe kur përdorin teknologji të reja. Çdo përmbajtje e publikuar duhet të jetë e verifikuar dhe të respektojë rregullat për citimin dhe referimin e burimeve.

Rreziku i imitimit të autorëve

Disa sisteme të Inteligjencës Artificiale janë të afta të prodhojnë përmbajtje që imiton stilin e autorëve të njohur ose të mediave të caktuara. Kjo mund të krijojë probleme etike dhe ligjore, veçanërisht kur përmbajtja paraqitet si origjinale. Gazetarët duhet të shmangin përdorimin e Inteligjencës Artificiale për të imituar qëllimisht stilin e autorëve të tjerë ose për të prodhuar përmbajtje që mund të krijojë konfuzion për audiencën.

Pronësia mbi përmbajtjen e prodhuar

Një nga çështjet më të debatueshme në lidhje me Inteligjencën Artificiale është pronësia mbi përmbajtjen e prodhuar nga këto sisteme. Duke qenë një teknologji e re dhe në zhvillim, kuadri rregullator për të drejtat e pronësisë së përmbajtjes së prodhuar nga Inteligjenca Artificiale është duke u diskutuar dhe plotësuar. Bashkimi Evropian ka një angazhim serioz në krijimin e kuadri të plotë ligjor në këtë drejtim. Miratimi i direktivës rregullatore (IA Act), dhe udhëzime mbi praktikën e ndaluar të Inteligjencës Artificiale të përcaktuara me rregullore (Guidelines on prohibited artificial intelligence practices established by Regulation)⁴⁹ në vitin 2024 përbëjnë dy dokumentet kryesore në këtë drejtim⁵⁰. Në shumë raste, rregullat ligjore për këtë çështje janë ende në zhvillim.

Megjithatë, nga perspektiva editoriale, përgjegjësia për përmbajtjen e publikuar i mbetet gjithmonë redaksisë dhe gazetarëve që e publikojnë atë. Për këtë arsye, përmbajtja e prodhuar me ndihmën e IA duhet të trajtohet si çdo material tjetër gazetaresk. Kjo përmbajtje duhet të verifikohet, të redaktohet dhe të miratohet përpara publikimit.

⁴⁹ <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/commission-publishes-guidelines-prohibited-artificial-intelligence-ai-practices-defined-ai-act>

⁵⁰ <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/regulatory-framework-ai>

NDËRTIMI I KAPACITETEVE PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE NË MEDIA

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në gazetari nuk varet vetëm nga teknologjia që përdoret, por edhe nga aftësitë dhe kapacitetet profesionale të gazetarëve dhe redaksive. Për të përdorur në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme këto teknologji, mediat duhet të investojnë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të stafit të tyre. Ndërtimi i kapaciteteve për përdorimin e Inteligjencës Artificiale përfshin jo vetëm trajnimin teknik, por edhe zhvillimin e një kulture editoriale që e kupton rolin e teknologjisë në gazetari dhe që respekton standardet profesionale dhe etike të profesionit.

Kjo pjesë e manualit trajton mënyrat se si redaksitë mund të zhvillojnë aftësitë e gazetarëve, të përcaktojnë përgjegjësitë editoriale dhe të krijojnë mundësi që edhe redaksitë më të vogla të përfitojnë nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale.

Si të zhvillojmë aftësitë e gazetarëve në përdorimin e IA

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në gazetari kërkon një nivel të ri kompetencash profesionale. Gazetarët nuk kanë nevojë të jenë specialistë të teknologjisë, por është e rëndësishme që ata të kuptojnë mënyrën se si funksionojnë mjetet që përdorin dhe cilat janë kufizimet e tyre. Trajnimi i gazetarëve për përdorimin e Inteligjencës Artificiale duhet të fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe në kuptimin e implikimeve etike dhe profesionale të këtyre teknologjive.

Për të përdorur Inteligjencën Artificiale në mënyrë të përgjegjshme, gazetarët duhet të kenë disa njohuri bazë mbi:

- mënyrën se si funksionojnë mjetet e Inteligjencës Artificiale
- kufizimet dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e tyre
- verifikimin e rezultateve të prodhuara nga IA
- mbrojtjen e të dhënave dhe privatisë
- standardet etike që lidhen me përdorimin e teknologjisë në gazetari

Këto njohuri ndihmojnë gazetarët të përdorin teknologjinë si një mjet mbështetës dhe jo si një zëvendësim për gjykimin profesional.

Trajnimi bazik dhe trajnimi i avancuar

Media mund të zhvillojë programe trajnimi në dy nivele kryesore. Trajnimi bazik synon të ofrojë njohuri të përgjithshme për Inteligjencën Artificiale dhe përdorimet e saj në gazetari. Ky trajnim mund të përfshijë:

- tema mbi funksionimin e teknologjive të IA
- demonstrime të mjeteve të ndryshme
- diskutime mbi rreziqet dhe implikimet etike

Trajnimi i avancuar mund të fokusohet në përdorimin e IA për detyra më specifike, si:

- analiza e të dhënave
- gazetaria e bazuar në të dhëna
- përdorimi i mjeteve të automatizimit në redaksi

Ushtrime praktike

Një nga mënyrat më efektive për të zhvilluar aftësitë e gazetarëve është përmes ushtrimeve praktike. Gazetarët mund të testojnë mjete të ndryshme të Inteligjencës Artificiale në projekte konkrete dhe të analizojnë rezultatet që prodhojnë këto sisteme. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një kuptimi më të thellë mbi mënyrën se si teknologjia mund të përdoret në praktikën gazetareske.

Gjithashtu organizatat e medias mund të organizojnë workshop-e për përdorimin e Inteligjencës Artificiale. Një workshop i tillë mund të përfshijë tema që lidhen me njohjen e mjeteve të ndryshme të Inteligjencës Artificiale, analiza të rasteve konkrete të përdorimit të IA në gazetari, diskutime mbi sfidat etike dhe profesionale dhe ushtrime praktike për përdorimin e mjeteve të ndryshme.

Këto aktivitete mund të ndihmojnë në ndërtimin e një kulture redaksionale që e kupton dhe e përdor teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme.

Si të përcaktojmë përgjegjësinë editoriale për përdorimin e IA?

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale nuk e ndryshon parimin themelor të gazetarisë: përgjegjësia për përmbajtjen e publikuar i mbetet gjithmonë redaksisë. Megjithatë, përdorimi i teknologjive të reja kërkon që redaksitë të përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me përdorimin e IA.

Roli i redaktorit

Redaktorët kanë një rol kyç në mbikëqyrjen e përdorimit të Inteligjencës Artificiale në redaksi. Ata duhet të sigurojnë që çdo përmbajtje e prodhuar me ndihmën e IA të verifikohet dhe të përputhet me standardet editoriale të medias. Redaktorët duhet gjithashtu të jenë të vetëdijshëm për kufizimet e teknologjisë dhe për rreziqet që lidhen me përdorimin e saj.

Roli i drejtuesve

Drejtuesit e medias janë përgjegjës për vendosjen e politikave dhe rregullave për përdorimin e Inteligjencës Artificiale. Kjo përfshin miratimin e mjeteve të IA që mund të përdoren nga stafi dhe zhvillimin e procedurave për mbikëqyrjen e tyre. Ata duhet gjithashtu të sigurojnë që gazetarët të kenë akses në trajnime dhe mbështetje për përdorimin e këtyre teknologjive.

Matrica e përgjegjësisë dhe llogaridhënies

Për të shmangur paqartësitë në lidhje me përdorimin e Inteligjencës Artificiale, redaksitë mund të zhvillojnë një matricë përgjegjësie që përcakton në mënyrë të qartë rolet dhe detyrat e secilit aktor të përfshirë në proces. Një strukturë e tillë ndihmon në qartësimin e vendimmarrjes për adoptimin e mjeteve të reja të IA, në përcaktimin e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e përdorimit të tyre në redaksi dhe në identifikimin e përgjegjësisë editoriale për përmbajtjen e prodhuar me IA dhe të publikuar. Po ashtu, kjo strukturë vendos procedura të qarta për trajtimin e gabimeve apo problematikave që mund të lindin nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale.

Si mund ta adoptojnë IA redaksitë e vogla dhe lokale?

Në mjedisin mediatik shqiptar një pjesë medias, veçanërisht ato lokale e zhvillojnë aktivitetin duke u bazuar në burime të kufizuara financiare dhe teknologjike. Pavarësisht sfidave dhe vështirësive që burojnë nga ky realitet, këto media mund të përfitojnë ndjeshëm nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale. Suksesi varet nga përcaktimi i një modeli apo mënyre të integritimit të IA, që i përshtatet më mirë strukturës, kulturës organizative dhe objektivave editoriale të vetë medias.

Së pari mund të nisesh nga përdorimi i mjeteve të thjeshta dhe me kosto të ulët, të cilat mund të automatizojnë detyra rutinë si transkriptimi, përkthimi, përmbledhja apo organizimi i informacionit. Kjo jo vetëm rrit

efikasitetin, por edhe i lejon gazetarët të fokusohen më shumë në përmbajtje me vlerë të shtuar.

Një element kyç është edhe ndërtimi i një qasjeje graduale dhe eksperimentale. Organizatat e medias lokale apo redaksitë e vogla të portaleve informative duhet të shmangin pritshmëritë e tepruara dhe të fokusohen fillimisht në raste konkrete përdorimi që sjellin përfitime të menjëhershme, si kursimi i kohës apo përmirësimi i mbulimit mediatik. Projekte të vogla pilot mund të testohen, të vlerësohen dhe më pas të zgjerohen nëse rezultojnë të suksesshme.

Në këtë proces, është e rëndësishme të qartësohet se Inteligjenca Artificiale nuk zëvendëson gazetarët, por mbështet punën e tyre duke reduktuar detyrat e përsëritura dhe duke hapur mundësi për zhvillimin e ideve të reja. Për këtë arsye, është thelbësore që stafi të trajnohet dhe të kuptojë rolin real të këtyre teknologjive, duke ulur pasiguritë dhe rezistencën ndaj ndryshimit.

Bashkëpunimi ndërmjet mediave përbën një tjetër mekanizëm të rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve. Shkëmbimi i përvojave, njohurive dhe praktikave të mira, si dhe organizimi i trajnimeve të përbashkëta, ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më të përgatitur për adoptimin e teknologjive të reja.

Njëherësh, suksesi i përdorimit të IA lidhet ngushtë me kuptimin e qartë të qëllimit. Media duhet të përcaktojë se çfarë problemi konkret synon të zgjidhë, dhe si IA mund të kontribuojë në këtë drejtim.

